

**DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE
QË LIDHEN ME
AGJENSINË KOSOVARE
TË PRIVATIZIMIT**

**SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF
KOSOVO ON
PRIVATISATION AGENCY
OF KOSOVO RELATED
MATTERS**

**SPECIJALNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU AGENCIJU
ZA PRIVATIZACIJU**

AC-I-12-0055

Në padin e

Paditësve

1.M.J.

2.B.J.

3.T.J.

4.R.J.

5.I.J., të gjithë nga XX të përfaqësuar nga M.G., rr.XX, Prishtinë

Kundër

E paditur

XX, Fushë-Kosovë.

Ankuesja pranë Trupit Gjykses

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit(AKM) , e përfaqësuar nga UNMIK-u
Kompleksi TSS, Prishtinë.

Ankuesja pranë Kolegjit të Apelit

Agjencia Kosovare e Privatizimit(AKP) rr."Ilir Konushevci" nr.8, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) i përbërë nga Mr.sc Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Merja Halme-Korhonen, Cornelis Van Der Weide, David Wilcox dhe Sabri Halili, gjyqtarë, duke vendosur në ankesën e AKP-së ndaj Aktvendimit të Trupit Gjykses SCA-08-0041, të datës 27 dhjetor 2011, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 30 prill 2013, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Trupit Gjyqësor të DHPGJS-së, SCA-08-0041, i datë 27 dhjetor 2011.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 20 korrik 2007, Kryetari i Gjykatës Komunale të Prishtinës ka lejuar përtëritjen e shkresave të lëndës së humbur nr.227/98, lidhur me çështjen gjyqësore në mes të paditësve dhe XX nga LS, duke qenë se ajo lëndë ishte humbur gjatë luftës në Kosovë dhe ajo është regjistruar me numër të ri 1738/07 (padi).

Me 24 shtator 2007, paditësit kanë ushtruar padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës dhe kanë kërkuar që t'i vërtetoj ata (si trashëgimtar të të ndjerit J.J.) si bashkëpronar të ngastrës kadastrale 1872/4 në LS, dhe të lejohet që e njëjta të regjistrohet në librat kadastral. Paditësit nuk kanë kërkuar anulimin e kontratës mbi shitblerjen të lidhur midis të ndjerit J.J. dhe të paditurës, lidhur me ngastrën kadastrale 1872/04 në LS. Paditësit nuk kanë ofruar kthimin e çmimit të shitblerjes tek e paditura. Paditësit kanë pohuar se në vitin 1961 paraardhësi i tyre ka qenë i detyruar që t'ia shes të paditurës ngastrën 1872/04 në LS, për çmimin 169,840 dinarë. Paditësit kanë pohuar se me lidhjen e kësaj kontrate janë shkel neni 3 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe neni 4 i Ligjit mbi Transferimin e Pasurisë së Patundshme (gazeta zyrtare e RSS nr. 43). Paditësit e kanë prezantuar një kontratë pjesërisht të lexueshme, e cila gjithashtu përmban ngastrat kadastrale 567/1 dhe 258/3 në LS, të cilat nuk janë objekt i padisë. Paditësit gjithashtu theksojnë se Sekretariati Rajonal i Financave në Prishtinë, me Vendimin numër 03-1894/62, të datës 18 qershor 1962, e ka shpronësuar ngastrën kadastrale 1872/04 në LS.

Më 19 nëntor 2007, Gjykata Komunale e Prishtinës e ka miratuar padinë e paditësve dhe e ka anuluar kontratën mbi shitblerjen e pasurisë së

III

patundshme Vr.nr. 1804/61, të datës 28 korrik 1961, e lidhur midis paraardhësit të paditësve J.J. nga LS dhe të paditurës. Gjykata ka obliguar të paditurën ta dorëzoj në posedim dhe në pronësi paditësve si pasardhës të të ndjerit J.J. , ngastrën kadastrale nr.202/1 me sipërfaqe prej 0.54,95ha , ndërsa janë obliguar paditësit t'i kompensojnë të paditurës shumën prej 241,35 euro. Gjykata kishte ardhur në përfundim se pohimet e paditësve janë të bazuara ngase kontrata ishte lidhur në presion të drejtpërdrejt nga regjimi i atëhershëm.

Aktgjykimi përmban edhe një këshill juridike se ankesa mund të paraqitet në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, brenda 15 ditëve nga dorëzimi i tij.

E paditura e ka pranuar Aktgjykimin C.nr. 1738/07 më 26 nëntor 2007, ndërsa ajo nuk ka paraqitur ankesë.

Me 13 mars 2008, AKM-ja ka paraqitur ankesë në DHPGJS, kundër Aktgjykimit C.nr 1738/07 dhe ka kërkuar që ai të anulohet, ngase Gjykata Komunale e Prishtinës nuk ka pasur kompetencë lëndore lidhur me padinë, ndërsa AKM-ja nuk ishte e njoftuar siç kërkon neni 29 i Rregullores së AKM-së, prandaj AKM-ja në ankesë ka theksuar se është shkelur neni 4.1 i Rregullores së AKM-së dhe nenet 15 dhe 16 të LPK-së. AKM-ja ka deklaruar se Gjykata Komunale në Prishtinë me aktgjykimin e kontestuar ka vendosur mbi meritën e padisë pa vërtetuar nëse paditësit e kanë njoftuar Agjencinë.

Më 27 dhjetor 2011, Trupi Gjykses i DHPGJS-së ankesën e AKM-së e refuzon si të papranueshme. Trupi Gjykses vjen në përfundim se ankesa është e pa afatshme dhe si e tillë e papranueshme. Trupi Gjykses ka theksuar se që nga data 24 shtator 2007 AKM-ja ishte e njoftuar për kontestin mes palëve si dhe për datën e mbajtjes së seancës së parë dëgjimore, mirëpo ajo nuk kishte zgjedhur që vet ta përfaqëson NSH-në e paditur. Trupi Gjykses në aktvendimin e kontestuar pranon se njoftimi nuk ishte bërë në formën siç kërkonte neni 29.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/18, megjithëse nuk ishte i kontestuar fakti se AKM-ja ishte e njoftuar për kontestin. Sipas Trupit Gjykses AKM-ja kurrë nuk kishte dorëzuar ndonjë dokument i cili do të tregonte se I.H.

IV

nuk është i autorizuar siç duhet me ligj për ta përfaqësuar NSH-në e paditur. Sipas Trupit Gjykses, neni 29.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/18 vetëm e lejon por nuk e obligon AKM-në për të ndërmarrë përfaqësimin e NSH-së, në rast se ajo është e paditur. Raporti midis Agjencisë dhe të paditurës është i brendshëm dhe e zgjidh se kush e merr përfaqësimin. Është e vërtetë se Agjencia nuk është njoftuar siç duhet para se të paraqitet padia në Gjykatën Komonale dhe Trupi Gjykses kishte pranuar se Gjykata Komonale nuk i ishte përmbajtur kërkesës së dispozitës së cekur ligjore, por kjo nuk do të thotë se AKM-ja nuk duhet të ndërmerr hetime si palë e matur dhe administratore e besuar për lëndët në zhvillim e sipër, pasi që AKM me kohë e ka marrë informatën për lëndët që presin zgjidhje pranë Gjykatës Komonale për të intervenuar si administratore e NSH-së. Trupi Gjykses cek se pasi që nuk ka fare prova se ndërmarrja shoqërore e paditur në atë kohë ka qenë nën administrim të drejtpërdrejt të AKM-së, nuk ka pasur arsye që Gjykata ta njoftojë AKM-në për aktgjykimin e saj të marrë dhe t'i dorëzohet drejtëpërdrejt asaj. Kjo, sipas Trupit Gjykses ka qenë detyrë e NSH-së, nëse kjo ishte e paraparë në marrëdhëniet e brendshme mes Agjencisë dhe ndërmarrjes. Trupi Gjykses në aktvendimin e kontestuar pohon se kurrë nuk e ka shqyrtuar meritën e aktgjykimit të Shkallës së I-rë, por vetëm aspektet procedurale gjatë marrjes së tij. Trupi Gjykses ka arritur në përfundim se të gjitha afatet kohore për ankesë madje edhe ato për mjete juridike të jashtëzakonshme kishin kaluar prandaj ankesa nuk ka mundur të trajtohet ndryshe pos si e pa afatshme dhe si e tillë edhe e papranueshme.

Vendimi i ankimuar i Trupit Gjykses i është dorëzuar AKM-së me datë 23 mars 2012, dhe përfaqësuesit të paditurit 22 mars 2012. Në afatin ligjor nuk ka pasur ankesë as nga paditësi as nga ankuesja pranë Trupit Gjykses - AKM-ja.

Më 30 maj 2012, me një parashtresë-urdhër SCA-08-0041, gjyqtarja përgjegjëse e lëndës, aktvendimin e ankimuar SCA-08-0041 e ka dërguar edhe tek AKP-ja, e cila e ka pranuar këtë aktvendim me 19 qershor 2012.

Më 18 korrik 2012, AKP-ja paraqet ankesë ndaj aktvendimit të Trupit Gjykses, e cila në procedurën para Trupit Gjykses nuk ishte ankuese. AKP-ja aktvendimin e Trupit Gjykses e konteston për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, kontastimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër në ankesë pretendohet se është shkelur neni 182.2 (n) i LPK-së, duke qenë se sipas ankuesës dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktvendimit, nuk ka fare arsye për faktet vendimtare ose ato arsye janë të paqarta dhe kontradiktore. AKP-ja pretendon se është shkelur edhe neni 182.1 lidhur me nenin 7.1.2.3 të LPK-së, ngase Trupi Gjykses nuk i ka vërtetuar faktet të cilat paditësit nuk i kanë paraqitur dhe nuk i kanë marrë parasysh propozimet e palëve të paraqitura në procedurë. Dhoma e Posaçme ka shqyrtuar vetëm çështjen e afatshmërisë së ankesës në aktvendimin e kontestuar, ndërsa nuk ka shqyrtuar disa fakte kryesore, çështjen e njoftimit të AKM-së si administratore ligjore e të paditurës, dhe çështjen e mungesës së juridiksionit të Gjykatës Komunale për ta shqyrtuar padinë. AKP-ja ka kërkuar që ankesa të aprovohet si e bazuar ,të ndryshohet aktvendimi i ankimuar i Trupit Gjykses dhe të refuzohet kërkesë padia si e pabazuar.

Paditësi në përgjigje të ankesës së AKP-së, në parashtresën e dorëzuar në DHPGJS me datë 31 korrik 2012 ,ka theksuar se AKM-ja ishte e njoftuar për kontestin gjyqësor që ishte në rrjedh e sipër mes palëve dhe për datën e seancës së parë dëgjimore, andaj AKM-ja ka mundur të paraqes ankesë të afatshme në DHPGJS nëse nuk ka qenë e kënaqur me aktgjykimin apo me përfaqësimin ligjor të NSH-së. Sipas paditësit, aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr 1738/07, i datës 19 nëntor 2007, ishte bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm në ditën e miratimit të tij. Trupi Gjykses i DHPGJS-së nuk ka shqyrtuar meritat e aktgjykimi të Gjykatës së Shkallës së I-rë, por vetëm aspektet procedurale gjatë marrjes së vendimit të saj, përfshirë edhe afatshmërinë e ankesës. Paditësi ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar i Trupit Gjykses të DHPGJS-së.

Ankuesja – AKP, më 16 nëntor 2012, dorëzon një parashtrësë në DHPGJS dhe i kundërpërgjigjet përgjigjes në ankesë së paditësit. Në parashtrësë ankuesja pohon se Gjykata Komunale ka vendosur jashtë juridiksionit të saj, është një çështje e gjykuar, dy aktvendime të të njëjtës Gjykatë janë në fuqi në të njëjtën kohë, aktvendimi i ankimuar është nxjerrë me shkelje procedurale, nuk është respektuar statusi ligjor i Agjencisë dhe kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar i Trupit Gjykues dhe të refuzohet kërkesë padia si e pabazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar. Bazuar në nenin 64.1 të Shtojcës së ligjit nr 04/L-033 të DHPGJS-së Kolegji i Apelit vendosi të përjashtoj pjesën gojore të procedurës.

Pranueshmëria e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Trupit Gjykues duhet të vërtetohet pasi që është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor.

Njoftimi i Agjencisë

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12 e datës 13 qershor 2002, e ndryshuar në nenin 29.1 ka paraparë që të njoftohet Agjencia për qëllimin e ngritjes së padisë, të cilin njoftim në bazë të nenit 30.2 e bënë paditësi në afat prej 60 ditësh para dorëzimit të padisë në Gjykatë. Qëllimi i njoftimit është të njoftohet Agjencia në lidhje me paditë potenciale, dhe tu ofrohet atyre mundësia që të merr përgjegjësinë në emër të NSH-së .

Nuk është kontestuese fakti se AKM-ja në këtë lëndë ishte e njoftuar për ngritjen e padisë ndaj të paditurit së paku nga 24 shtatori 2007, kur u mbajt seanca e parë dëgjimore, do të thotë afro dy muaj para se të nxirret aktgjykimi i Gjykatës Komunale, i cili ka mbetur i pa ankimuar në afatin ligjor nga palët e përfshira në procedurë. Edhe pse njoftimi i AKM-së nuk ishte bërë në afatin ligjor siç kërkon neni 30.2 i Rregullorës së UNMIK-ut 2002/12, kjo rrethanë nuk e arsyeton AKM-në në

VII

pretendimin e dhënë në ankesën ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale, se njoftimi i Agjencisë nuk ishte bërë në formën e duhur. Megjithëse njoftimi i Agjencisë kishte ndodhë në një fazë të mëvonshme procedurale ende pa u vendosur në meritat e padisë, AKM-ja ende ka pasur mundësi por nuk kishte vendosur që vet ta përfaqësoj të paditurën dhe as që kishte kontestuar ndonjëherë faktin se i autorizuari i të paditurës nuk ishte personi i duhur dhe ligjor, për ta përfaqësuar të paditurën. Ngritja e problemit për përfaqsim jo ligjor dhe jo adekuat të NSH-së, nuk mund të bëhet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

A e kishte vënë AKM-ja ende nën autoritetin administrativ NSH-në e paditur

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12 e datës 13 qershor 2002, i ka dhënë autorizim ligjor AKM-së që t'i vënë nën autoritetin administrativ dhe t'i administrojë të gjitha NSH-të në territorin e Kosovës. Kjo rregullore ka hyrë në fuqi me 13 qershor 2002, dhe në këtë ditë AKM-ja nuk ka mundur faktikisht t'i vënë nën administrim të gjitha NSH-të, përfshirë edhe të paditurën. Procesi i vënies nën administrim dhe marrja e përgjegjësisë (përfshirë edhe përfaqësimin), natyrshëm ka zgjatur dhe në të njëjtën kohë është e sigurt se AKM-ja nuk ka mundur ta shtrij autoritetin administrativ ndaj të gjitha NSH-ve. Prandaj AKM-ja në këtë rast nuk ka afruar prova për Gjykatën se në kohën e ngritjes së padisë e kishte kontrollin administrativ ndaj NSH-së së paditur dhe se ajo ishte e vetmja përfaqësuese ligjore që duhej ta kryente përfaqësimin e saj. Për këtë fakt barra e provës bie mbi AKM-në.

Rregulloja e UNMIK-ut 2002/12, kishte siguruar bazën ligjore për AKM-në që ti vë nën autoritetin administrativ NSH-të, ndërsa është dashur të zhvillohen proceset operative nga AKM-ja për ta realizuar faktikisht autoritetin e dhënë ndaj NSH-ve, që në këtë rast nuk dihet se ndaj NSH-së së paditur kur kanë filluar të merren përgjegjësit ligjore (përfshirë edhe përfaqësimin). Duke qenë se AKM-ja nuk e kishte kontestuar asnjëherë përfaqësimin që e kishte bërë i autorizuari i të paditurës në procedurat para Gjykatës Komunale, ajo në këtë fazë të vonshme të procedurës nuk mund më të pretendojë se përfaqësimi nuk ishte i rregullt.

Dorëzimi i aktgjykimit të Gjykatës Komunale

Duke qenë se në procedurat pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, vetëm paditësi dhe e paditura ishin palë në procedurë, ndërsa AKM-ja nuk kishte vendosur që të përfshihet në procedurë dhe ta përfaqësoj të paditurën, Gjykata Komunale e ka kryer

VIII

detyrën e vet ligjore, kur aktgjykimin e kontestuar ua ka dorëzuar vetëm palëve të përfshira në procedurë. Dorëzimi i aktgjykimit të kontestuar palës së paditur është një fakt i pakontestuar. E paditura nuk ka vendosur të paraqesë ankesë në afatin ligjor dhe as më vonë asnjëherë nuk ka paraqit ankesë.

AKM-ja, siç pretendon ajo, vetëm më 11 janar 2008 është njoftuar për aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komunale, në bazë të parashtresës së Kryetarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili në parashtresë kërkonte lejimin e regjistrimit të pronës në bazë të aktgjykimit në fjalë. Kjo parashtresë e Kryetarit të Gjykatës Komunale dërguar AKM-së, nuk do të thotë dhe nuk mund të interpretohet se në atë kohë Gjykata ka dashur ta dorëzoj aktgjykimin një pale e cila nuk ishte e përfshirë në procedurë, ngase natyra ligjore e parashtresës është kërkesa për lejimin e regjistrimit të pronës, e jo dorëzimi i aktgjykimit, nga i cili mund të rrjedh afati i ri ligjor për të paraqitur ankesë. Nga ky këndvështrim i këtyre fakteve, Kolegji i Apelit, datën 11 janar 2008, nuk e konsideron si datë të dorëzimit të aktgjykimit për të rrjedhë afati i ankesës, për arsye se AKM-ja nuk ishte e përfshirë në procedurë pranë Gjykatës Komunale, megjithëse ishte e njoftuar për padinë.

Ankesa e paafatshme e AKM-së

Nga arsyet e dhëna më lartë, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se AKM-ja nuk ka paraqitur ankesë të afatshme, dhe si e tillë ajo është dashur të hidhet poshtë si e pa pranueshme. Kolegji i Apelit i pranon si korrekte arsyet e Trupit Gjykses të dhëna në aktvendimin. Parimi i sigurisë ligjore të palëve është parim fundamental i një sistemi ligjor. Palët duhet të ndihen të sigurt se vendimet e formës së prerë nuk do të mund të kontestohen asnjëherë, nga asnjëra palë, pasi që të kaloj afati ligjor për kontestimin e tij. Kolegji i Apelit pajtohet me përfundimin e Trupit Gjykses se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk është shqyrtuar në merita dhe se ai nuk ka shprehur qëndrim ligjor, nëse ai aktgjykim ishte marrë nga Gjykata Komunale në mungesë të juridiksionit. Të metat procedurale të ankesës së ankuesës- AKM e kanë penguar Trupin Gjykses të hyjë më tej në shqyrtimin e meritave të aktgjykimit të Gjykatës Komunale, sepse nëse aspekti procedural i ankesës nuk është në linjë me ligjin, nuk ka mundësi ligjore të shqyrtimit të meritave të saj, për të ardhur në përfundim nëse aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Komunale ishte i bazuar apo jo në ligj.

Nga arsyet e cekura Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e AKP-së, si trashëgimtare e ish AKM-së, e paraqitur në procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, nuk ka

IX

mundur të aprovohet si e bazuar, pasi që aktgjykimi i ankimuar i Trupit Gjykses mbështetet në arsyetimin e duhur ligjor.

Andaj në bazë të nenit 10 paragrafi 10 i LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Shpenzimet/taksat gjyqësore:

Gjykata nuk i ka caktuar taksat gjyqësore për Apeluesin sepse presidiumi i gjykatës deri më tani nuk e ka nxjerrë ndonjë plan tarifor me shkrim të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57, paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri me tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për caktimin e shpenzimeve.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 30 prill 2013.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT :

Luteni ta dërgoni këtë Aktvendim te:

- Apeluesi (përfshirë përkthimin e aktvendimit në gjuhën angleze)
- Paditësi dhe e paditura,
- Kryesuesit të Trupit Gjykues në lëndën SCA-08-0041.

Mr.sc. Sahit Sylejmani

Gjyqtar Kryesues